



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 83, datë 29.06.2020**

**PËR**

**RIEMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË  
ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“SIGMA INTERALBANIAN VIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Riemërimin e z. Klaidi Çitozi, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Bordit të Drejtorëve si dhe riemërimin e z. Ervin Rali, në cilësinë e anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian VIG” sh.a., për një periudhë 3-vjeçare.
2. Riemërimin e z. Peter Hofinger, z. Jonadri Prodani, z. Christoph Rath dhe zj. Sonja Raus, si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian VIG” sh.a., për një periudhë 3-vjeçare.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**  
**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**